SAFETY GALA ALBANIA

Dr. Ing. Ardit Gjeta

Lecturer
Polytechnic University
of Tirana



SAFETY GALA ALBANIA

ORGANIZED BY

ERMC member of MANAGEMENT FORCE Group

RISK MANAGEMENT & EHSS CONSULTANCY SERVICES

Kontributi i Universitetit Politeknik të Tiranës për Sigurinë dhe Shëndetin në Vendin e Punës

Prof. Asoc. Majlinda ALCANI

Dr. Ing. Ardit GJETA

agjeta@fim.edu.al



Misioni i Universitetit Politeknik të Tiranës

Krijimin, transmetimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve

Ofrimin e mundësive për arsim të lartë gjatë gjithë jetës në fushat e ekspertizës së tij.

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike në UPT

Pjesë e Universitetit Politeknik të Tiranës (themeluar në vitin 1951)

Partneritetet me industrinë:
Bashkëpunime me kompanitë inxhinierike për të rritur mundësitë e trajnimit praktik dhe punësimit

Anëtarët e fakultetit:
Mbi 70+ profesorë me përvojë dhe staf kërkimor/ shkencor

Projektet kërkimore:

Angazhuar në 50+ bashkëpunime të vazhdueshme kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare

Programet e ofruara:
Diploma Bachelor, Master dhe Doktoraturë

Vizioni:

Synon të zgjerojë ofertën akademike në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Rritja dhe zhvillimi i FIM

Gjatë dekadave, fakulteti ka zgjeruar ofertat e tij akademike për të përfshirë kurse më të specializuara në përgjigje të përparimeve teknologjike dhe kërkesave të industrisë.

Gjithashtu ofron kurse të formimit të vazhduar profesional të përshtatura për nevojat në zhvillim të profesionistëve në industri.

Angazhimi për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë

Referuar Strategjisë Evropiane dhe Globale për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë:

- Raporti i Progresit të Shqipërisë 2023, i hartuar nga Komisioni për Parlamentin Evropian, **rekomandon:**

- Shqipëria duhet **të miratojë strategjinë e re 2024 - 2030 për shëndetin dhe sigurinë në punë, me fokus në forcimin e kapaciteteve institucionale për të mundësuar zbatimin e legjislacionit në mënyrë efektive** dhe miratimin e strategjisë kombëtarë te mbrojtjes sociale 2024-2030.

- Për të realizuar këtë, Qeveria e Shqipërisë ngriti një grup ndërinstitucional me pjesëmarrjen e shumë aktorëve dhe palëve të interesuara të kësaj fushe, pjesë e të cilit ka qënë edhe UPT.

Angazhimi për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

PËR

MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKAVE PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË 2024 - 2030 DHE PLANIT TË VEPRIMIT

- **ka për qëllimin vazhdimin e reformave të fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, reflektimin e ndryshimeve që kanë ndodhur në botën e punës** gjatë viteve të zbatimit të dokumentit të mëparshëm “Dokumentit Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, 2016-2020”.

Objektivat Kryesore

- Përshtatja e institucioneve dhe politikave të sigurisë dhe shëndetit në punë me sfidat aktuale dhe të ardhshme.
- Forcimi i qeverisjes dhe menaxhimit të institucioneve përgjegjëse për sigurinë dhe shëndetin në punë.
- Rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e sigurisë dhe shëndetit në punë për të garantuar kushte të denja pune.

- Gjithashtu, hartimi dhe miratimi i këtij dokumenti politikash përmbush një nga rekomandimet e dhëna në "Raportin e Progresit për Shqipërinë, 2023", për Kapitullin 19 "Politikat Sociale dhe të Punësimit", **në kuadër të procesit të negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.**

Angazhimi për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë

Një nga 5 objektivat e Planit të Veprimit të parashikuar ka qënë:

Zhvillimi dhe shpërndarja e njohurive

Informacioni dhe njohuritë mbi Shëndetin dhe Sigurinë në Punë (SSHP) zhvillohen dhe përmirësohen vazhdimisht për të përmbushur nevojat e ndryshme të vendeve anëtare të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO).

Aktualisht është hartuar drafti dhe projektvendimi “Për miratimin e Dokumentit te Politikave për sigurinë dhe Shëndetin ne Pune 2024-2030 dhe Planit te Veprimit”, i cili ju është dërguar gjithë institucioneve te lidhura me këtë fushe për mendim.

Strategjia e re për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2024-2030

Prioriteti Strategjik A1: Përmirësimi i kuadrit ligjor të SSHP.

Prioriteti Strategjik A2: Përmirësimi i sistemeve të hetimit dhe raportimit të aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale.

Prioriteti Strategjik A3: Krijimi i një sistemi për trajnimin, certifikimin dhe licencimin e ekspertëve dhe shërbimeve të SSHP

- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të SSHP dhe ekspertiza e profesionistëve brenda kompanive është thelbësore për kultivimin dhe sigurimin e një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm pune.

Hapja e KFV Siguria dhe Shëndeti në Punë

<u>5 javet e para</u> (1.11.2024 **–** 14.12.2024**)**

1) Moduli 1 (**Baza ligjore për SSHP, Analiza dhe Vlerësimi i Riskut** –A. Hoxha)
2) Moduli 2 (Siguria dhe Shëndeti në **Industrinë e Proceseve** –M. Alcani)
3) Moduli 3 (Siguria dhe Shëndeti në **Sektorin e Shërbimeve për Materialet dhe Mallrat** –A. Dorri)

<u>5 javet e dyta</u> (20.12.2024 **-** 1.02.2025**)**

1) Moduli 4 (**Sistemet e Menaxhimit** të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë **–**A. Stermasi)
2) Moduli 5 (Siguria dhe Shëndeti **në Shfrytëzimin e Pajisjeve Elektrike** –A. Mucka)
3) Moduli 6 (Siguria dhe Shëndeti **në Shërbimet Administrative** –E. Bebi)

<u>5 javet e treta</u> (7.02.2025 **–** 8.03.2025**)**

1) Moduli 7 (Siguria dhe Shëndeti **në Shërbimet e Ofruara nga Njerëzit** - A. Gjeta)
2) Moduli 8 (Siguria dhe Shëndeti **në Shërbimet Infrastrukturore** –J. Thanas)
3) Moduli 9 (Siguria dhe Shëndeti **në Kantieret e Përkohshëm ose të Lëvizshëm** – O. Koca – A. Gjeta)

Hapja e KFV Siguria dhe Shëndeti në Punë

Mësimi do të zhvillohet dy herë në javë:

- 3 orë mësimore ditën e premte;
- 7 orë mësimore ditën e shtunë.

MODULI		Nr. i Javeve: Fillon 1.11.2024																	
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19
I																			
II																			
III																			
IV	1.11.2024				14.12.2024														
V																			
VI																			
VII						20.12.2024				1.02.2025									
VIII																			
IX																			
											7.02.2025				8.03.2025				
Provime					P 1, 2, 3					P 4, 5, 6					P 7, 8, 9				
Punimi perfundimtar																			

Kontributi i UPT për zbatimin dhe suksesin e Strategjisë së Sigurisë dhe Shëndetit në Punë 2024 - 2030

- **Organizimi i kurseve të trajnimit dhe certifikimit** për specialistë të sigurisë dhe shëndetit.

- **Kryerja e studimeve shkencore** për identifikimin e rreziqeve në vendin e punës në sektorët kryesorë, si ndërtimi, minierat, bujqësia, etj.

- **Pjesëmarrja në projektet** për harmonizimin e legjislacionit kombëtar me atë të BE-së në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë.

- **Organizimi i fushatave për ndërgjegjësimin** mbi sigurinë dhe shëndetin në punë përmes konferencave, seminareve dhe publikimeve, duke synuar studentët, punonjësit dhe kompanitë.

Universiteti ka një ndikim thelbësor në zhvillimin e një kulture të qëndrueshme të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës, **duke kontribuar në përmirësimin e kushteve të punës dhe rritjen e mirëqenies së punonjësve.**

Faleminderit për vëmendjen!